



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr.154, datë 06.12.2021

PËR

MIRATIMIN E PËRDORIMIT DHE DETAJIMIT TË FONDIT PREJ 388'182'835 LEKË PA TVSH NË ZBATIM TË VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.715, DATË 24.11.2021 "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RIKONSTRUKSIONIT E TË RIPARIMIT TË MJEDISEVE NË BASHKËPRONËSI OSE TË PËRBASHKËTA NË NDËRTEA (PALLAT) NË BASHKITË TIRANË, DURRËS DHE MIRDITË"

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Ligjit nr.68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Ligjit nr.137/2020, "Për buxhetin e vitit 2021" i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.715, datë 24.11.2021 "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rikonstruksionit e të riparimit të mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallat) në bashkitë Tiranë, Durrës dhe Mirditë", Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.123, datë 24.12.2020 "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2021, si dhe projektbuxhetin afatmesëm të Bashkisë Durrës për vitet 2021-2023", si dhe sipas relacionit të hartuar nga Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria e Projekteve dhe Infrastrukturës Publike, me propozim të Zëvendëskryetares së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Miratimin e përdorimit dhe detajimit të fondit prej 388'182'835 (treqind e tetëdhjetë e tetë milionë e njëqind e tetëdhjetë e dy mijë e tetëqind e tridhjetë e pesë) lekë pa TVSH, të

përfituar në formën e transfertës së pakushtëzuar nga fondi i rindërtimit i buxhetit të shtetit, sipas tabelës, detajuar si më poshtë:

Emërtimi	Vlera e plotë	Financimi për vitin 2021	Financimi për vitin 2022
Rikonstruksioni dhe riparimi i mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallat), Bashkia Durrës	383.356.285 lekë	76.756.431 lekë	306.599.854 lekë
Mbikëqyrja	4.400.678 lekë	880.136 lekë	3.520.542 lekë
Kolaudimi	425.872 lekë		425.872 lekë
Totali	388.182.835 lekë	77.636.567 lekë	310.546.268 lekë

2. Financimi për vitin 2021, sipas pikës 2/b, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.715, datë 24.11.2021 “Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rikonstruksionit e të riparimit të mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallat) në bashkitë Tiranë, Durrës dhe Mirditë”, do të jetë në masën 77’636’567 (shtatëdhjetë e shtatë milion e gjashtëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi, Drejtoria e Buxhetit, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Sektori i Prokurimeve dhe Drejtoria e Projekteve dhe Infrastrukturës Publike, Bashkia Durrës.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 06.12.2021



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 958 / prot.
2

Durrës, më 13 . 12 . 2021

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit



13.12.21 12888/3

KËSHILLIT BASHKIAK ✓
DURRËS

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.154 datë 06.12.2021 “Për miratimin e përdorimit dhe detajimit të fondit prej 388.182.835 lekë pa TVSH në zbatim të VKM Nr 715 dt 24.11.2021 “ Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rikonstruksionit e të riparimit të mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallat) në Bashkitë Tiranë, Durrës dhe Mirditë”

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

ROLAND NASTO

